



Inicijativa za REKOM
Initiative for RECOM
Иницијатива за РЕКОМ
Nisma për KOMRA
Pobuda za REKOM

Progresi i procesit KOMRA 5.11.2014.

Ndryshimet e Statutit KOMRA Në kontekst të mundësive kushtetuese dhe ligjore për KOMRA-n

Koalicioni për themelimin e Komisionit Rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut, në datën 26 mars të vitit 2011 ka miratuar Statutin e këtij Komisioni si propozim të aktit ligjor, me të cilin themelohet ky Komision (KOMRA). Në fushatën për themelimin e KOMRA-s, gjatë muajit maj dhe qershor të vitit 2011, Koalicioni për KOMRA-n (Koalicioni) ka mbledhur 550.000 nënshkrime të qytetarëve nga të gjitha vendet post-jugosllave, të cilat e mbështesin themelimin e KOMRA-s. Pas qytetarëve, përkrahje të hapur kësaj nisme rajonale i kanë dhënë edhe përfaqësuesit më të lartë të shteteve, të krijuara në territorin e ish Jugosllavisë. Me qëllim të konkretizimit të përkrahjes së shprehur politike dhe bartjes së Nismës KOMRA në nivel shtetëror, Koalicioni ka kërkuar nga kryetarët/Presidenca e B dhe H për të emëruar të dërguarit personal për KOMRA-n (të dërguarit), të cilët do të analizojnë Statutin e Komisionit, të cilin e ka propozuar Koalicioni, në kontekst të mundësive ligjore dhe kushtetuese për themelimin e KOMRA-s, në secilin prej vendeve të veçanta dhe që në bazë të propozimeve të të dërguarve të vet ta fillojnë procedurën për themelimin e Komisionit. Emërimi i të dërguarve ka zgjatur pothuajse dy vite. Të dërguarit kanë filluar me punë në datën 8 shtator të vitit 2013. Deri në datën 28 tetor të vitit 2014, kanë përfunduar me analizën e Statutit dhe i kanë kryer konsultimet me kryetarët/dy anëtarët e Presidencës së Bosnjës dhe Hercegovinës mbi periudhën dhe fushën e hulumtimit të KOMRA-s, për çka vet nuk kanë qenë në gjendje për të sjellë vendim.

Për shkak të zgjedhjes së anëtarëve të ri të Presidencës së B dhe H, në datën 13.10.2014, avokuesit publik, pas konstituimit të Presidencës në mesin e muajit nëntor të vitit 2014, i kanë kryer konsultimet me anëtarin e ri kroat lidhur me atë nëse ai pajtohet me qëndrimet e anëtarit kroat paraprak të Presidencës, si dhe me anëtarin serb mbi emërimin e të dërguarit për KOMRA-n dhe bashkimin në projektin ndërshtetëror¹.

Të dërguarit për KOMRA-n² në përbërjen e mëposhtme: prof. dr Zlata Gjurgjeviq, profesoreshë e rregullt në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Zagrebit, e dërguar e kryetarit të Kroacisë Ivo Josipović; Selim Selimi, këshilltar personal ligjor i kryetares së Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, i dërguar i presidentes së Kosovës; Goran

¹ Anëtar i deritashëm serb i Presidencës së B dhe H, Nebojska Radmanović, asnjëherë nuk e ka pranuar delegacionin e Koalicionit mbi Nismën për KOMRA-n. Nuk i është përgjigjur as kërkesës me shkrim të Koalicionit për të emëruar të dërguarin e tij për KOMRA-n.

² Luben Arnaudovski, i dërguar i kryetarit të Maqedonisë Gjorge Ivanovit, nuk ka marrë pjesë në punën e të dërguarve për KOMRA-n. Kryetari i Maqedonisë, në datën 28 tetor të vitit 2014 e ka informuar Koalicionin për KOMRA-n se, nëse do të ketë konsensus, midis kryetarëve të shteteve të rajonit, edhe ai do ta fillojë procedurën për themelimin e KOMRA-s.

Mihaljeviq, ekspert ligjor për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës, i dërguar i anëtarit të Presidencës së B dhe H, Zheljko Komshiq; Sinisha Vazhiq, gjyqtar i Gjykatës së Apelit në Beograd, i dërguar personal i kryetarit të Serbisë, Tomislav Nikoliq; prof. dr Sonja Tomoviq-Shundi, dekan e Fakultetit të Shkencave Politike në Podgoricë dhe këshilltare personale për të drejtat e njeriut dhe të pakicave e kryetarit të Republikës së Malit të Zi dhe Aljosh Çampara, nënkryetar i Sarajevës, i dërguar i anëtarit të Presidencës së B dhe H, Bakir Izetbegović, Kanë mbajtur katër takime të punës, në të cilat e kanë analizuar secilën dispozitë të veçantë të Statutit të KOMRA-s, kanë marrë pjesë në e-mail komunikime rreth formulimeve ndryshim dhe paragrafë të ri, kurse në lidhje me dilemat për periudhën dhe fushën e hulumtimit i kanë kryer konsultimet me kryetarët/anëtarët e Presidencës. Rezultat i punës së tyre janë **Ndryshimet e Statutit të KOMRA-s**, të cilat bazohen në mundësitë ligjore dhe kushtetuese për themelimin e KOMRA-s, në secilin vend të veçantë të ish RSFJ-së, dhe e kultivojnë vullnetin e fuqishëm politik të kryetarëve/dy anëtarëve të Presidencës së B dhe H që së bashku të themelojnë Komisionin Rajonal, i cili do ta sigurojë një regjistër të plotë mbi krimet e kryera në luftërat dhe në lidhje me to. Dallimet në qëndrime të kryetarëve/anëtarëve të Presidencës lidhur me atë nëse KOMRA duhet të merret edhe me „rrethanat shoqërore-politike, të cilat në mënyrë vendimtare i kanë kontribuar shpërthimit të luftërave ose formave të tjera të konfliktit të armatosur dhe kryerjes së krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut“ i përgjigjen mendimeve të shprehura në procesin konsultativ mbi mandatin e KOMRA-s, që e ka organizuar Koalicioni e që janë përfshirë edhe me Statut, të cilin e ka propozuar Koalicioni.

Preambula

Të dërguarit e kanë përforcuar preambulën edhe me paragrafin e ri mbi dënimin moral të të gjitha krimeve dhe të kryerësve të tyre.

„Të vendosur për të respektuar parimet morale të gjykimit të të gjitha krimeve të luftës dhe kryerësit e tyre si dhe të gjitha format e shkeljes së të drejtave të njeriut“; - nen i ri, të dërguarit për KOMRA.

PJESA I – Domethënia e nocioneve në këtë Statut

Të dërguarit i kanë hequr përkufizimet, të cilat kanë të bëjnë me ministrat përgjegjës për të drejtat e njeriut dhe organin parlamentar për të drejtat e njeriut dhe ato të pakicave, sepse me ndryshimet ato nuk kanë më kurrfarë roli në zgjedhjen e komisionit seleksionues dhe të anëtarëve të Komisionit.

PJESA II – Dispozitat e përgjithshme

Të dërguarit kanë saktësuar se Komisioni krijohet mbi bazën e marrëveshjes ndërkombëtare dhe se Komisioni mund të vazhdojë punën e tij nëse i ka të siguruar mjetet financiare.

“Komisioni rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në territorin e ish RSFJ-së themelohet me këtë marrëveshje ndërkombëtare”. - ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Komisioni rajonal për vërtetimin e fakteve, për krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut në territorin e RSFJ-së së dikurshme, është Organizatë Ndërkombëtare e themeluar me këtë akt ligjor) – Propozim i Koalicionit për KOMRA , e fshirë.

Pjesa III – Obligimi i bashkëpunimit me Komisionin

Të dërguarit për KOMRA-n kanë saktësuar formulimin se shtetet do të krijojnë kushte për bashkëpunim të frytshëm me Komisionin.

PJESA IV – objektivat dhe detyrat e Komisionit

Të dërguarit për KOMRA-n kanë propozuar që Komisioni, midis objektivave të tjerë (neni 13), duhet:

g) **“t’i kontribuojë përparimit të programeve arsimore në pajtim me faktet mbi krimet e luftës, shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut dhe viktimat, të cilat i konstaton Komisioni”**. – nen i ri, të dërguarit për KOMRA.

Në konsultime të veçanta me të dërguarit dhe avokuesit publik të KOMRA-s, të kryera nga data 1 qershor deri në datën 28 tetor të vitit 2014, anëtari boshnjak dhe kroat i Presidencës së B dhe H, kryetarët e Kroacisë, Serbisë dhe Malit të Zi dhe presidentja e Kosovës kanë shprehur të njëjtin botëkuptim lidhur me objektivin kryesor të Komisionit (neni 13):

“Të vërtetoj faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në periudhën prej datës 1 janar të vitit 1991 e deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001 në ish RSFJ”; - qëndrimi i anëtarit boshnjak të Presidencës së B dhe H në mandatin e kaluar dhe të ri, i anëtarit kroat të Presidencës së B dhe H në mandatin e kaluar, i kryetarëve të Serbisë, Kroacisë, Malit të Zi, dhe presidentes së Kosovës. Krahas kësaj – **“Të vërtetoj faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në periudhën prej datës 1 janar të vitit 1991 e deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001 në ish RSFJ”** (neni 13) anëtari boshnjak i Presidencës së B dhe H, angazhohet që KOMRA **„të hulumtoj rrethanat politike dhe shoqërore, të cilat në mënyrë vendimtare kanë ndikuar në shpërthimin e luftërave ose formave të tjera të konfliktit të armatosur, si dhe kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut”** (neni 14).

Me këtë, propozimi i Koalicionit për KOMRA-n, ashtu siç është formuluar në pikën (a) neni 13 **„të vërtetojë fakte për krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në hapësirat e RSFJ-së së dikurshme, në periudhën nga 1 Janari i vitit 1991 deri më 31 Dhjetor të viti 2001, rrethanat politike dhe shoqërore, të cilat kanë ndikuar në kryerjen e këtyre veprave dhe pasojat të cilat janë rrjedhojë e këtyre krimeve dhe shkeljeve të të drejtave“** – është ndryshuar me qëndrimet e kryetarëve dhe të dy anëtarëve të Presidencës së B dhe H.

Pjesa V – Kompetencat e Komisionit

Në konsultime të veçanta lidhur me periudhën dhe fushat e hulumtimit, anëtari kroat dhe boshnjak i Presidencës së B dhe H, kryetarët e Kroacisë, Serbisë, Malit të Zi dhe presidentja e Kosovës, pavarësisht nga njëri-tjetri, kanë rekomanduar që KOMRA të hulumtojë faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në periudhën prej datës 1 janar të vitit 1991 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001, që është përfshirë edhe me mandatin e Tribunalit të Hagës, krahas faktit që anëtari boshnjak i Presidencës së B dhe H ka propozuar që Komisioni, me anë të hulumtimit, të përfshijë edhe **„rrethanat politike dhe shoqërore, të cilat në mënyrë vendimtare i kanë kontribuar shpërthimit të luftërave dhe formave të tjera të konflikteve të armatosura, si dhe kryerjes së krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut“**.

Pjesa VI – Kompetencat e Komisionit

Të dërguarit për KOMRA-n i kanë hequr kompetencat represive të Komisionit, të propozuara me nenet 17 dhe 21.

Pjesa VII – Zgjedhja e anëtarëve dhe e anëtareve të Komisionit

Të dërguarit për KOMRA-n në masë të madhe e kanë thjeshtësuar procedurën e zgjedhjes së komisionit seleksionues dhe të anëtarëve të Komisionit. Rolin qendror në zgjedhjen e komisioneve seleksionuese dhe të anëtarëve të Komisionit e kanë marrë kryetarët / Presidenca e B dhe H, krahas përkrahjes teknike të Koalicionit për KOMRA-n.

Pjesa VIII – Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve/anëtareve të Komisionit

Të dërguarit për KOMRA-n e kanë saktësuar mënyrën e mbrojtjes së burimit dhe të të dhënave të besueshme, të cilat i ka siguruar Komisioni gjatë punës së tij. Paragrafi i ri i të dërguarve është „**Komisioni nuk është i autorizuar që prokurorisë t’ia jep të dhënat dhe të zbulojë identitetin e personit, i cili i ka dhënë të dhënat pa pëlqimin e atij personi**“.

Pjesa IX – Struktura e Komisionit

Të dërguarit e kanë thjeshtësuar mënyrën e themelimit të ekipeve hetimore të Komisionit.

Pjesa X – Financimi i Komisionit

Të dërguarit për KOMRA-n kanë paraparë donacione si dhe mjete të organizatave ndërkombëtare, si burim themelor i financimit të Komisionit në vend të propozimit të Koalicionit për KOMRA-n, i cili i ka obliguar shtetet që aktivitetet e Komisionit të financohen nga mjetet buxhetore.

Pjesa XI – Raporti përfundimtar i Komisionit

Është saktësuar dispozita mbi mundësinë e përgjigjes së personit në pjesët mbi përgjegjësinë për krime të luftës përkatësisht për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, si dhe se kryetari, me kryetarin e parlamentit, do të thërrasë mbledhjen e parlamentit.

Anëtari boshnjak i Presidencës së B dhe H e ka përplotësuar nenin 44 mbi përmbajtjen e raportit përfundimtar me rekomandimin që raporti përfundimtar „**të përshijë edhe rrethanat politike dhe shoqërore, të cilat në masë vendimtare kanë ndikuar në fillimin e luftërave ose formave të tjera të konfliktit të armatosur, si dhe kryerjen e krimeve dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.**“

Pjesa XII – Të ndryshme

Të dërguarit për KOMRA-n i kanë hequr dispozitat ndëshkimore (neni 48 dhe neni 49), që kanë të bëjnë me rolin e Komisionit në procesimin e krimeve të luftës, sepse paraprakisht i kanë hequr kompetencat represive të Komisionit.

Pjesa XIII – Dispozitat përfundimtare

Të dërguarit për KOMRA-n kanë paraparë që palët kontraktuese do të vendosin mbi mënyrat e pranimit përkatësisht të ratifikimit të këtij dokumenti, përkatësisht palët kontraktuese dhe Këshilli për bashkëpunim rajonal do të informoj mbi pranimin përkatësisht mbi ratifikimin e këtij dokumenti.

Të dërguarit për KOMRA-n kanë rekomanduar që Koalicioni për KOMRA-n të marrë pjesë në përgatitjet teknike, profesionale dhe organizative për themelimin e komisioneve seleksionuese dhe Komisionit.